



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 108, Datë 22.04.2021

MBI

MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË PËRBASHKËTA TË SHLYERJES PËR SHKËMBIMIN E ENERGJISË NË PËRPTHJE ME NENET 50(3) DHE 51(1), TË KOMISIONIT RREGULLATOR TË BASHKIMIT EUROPIAN 2017/2195”

Në mbështetje të neneve 16, 20 dhe 55, pika 3, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe neneve 15 e 26, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 22.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/5 prot, datë 20.04.2021 të Drejtorive Teknike, «Mbi miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”»,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 77, datë 19.03.2021, ka vendosur fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a) për miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 494 prot., datë 31.03.2021, të ERE-s, vendimi sipërcituar, i është përcjellë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe shoqërisë OST sh.a.
- Dokumentacioni shoqëruar i “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, është publikuar në faqen zyrtare të ERE (www.ere.gov.al), që nga data 1 Mars 2021, në rubrikën “Konsultime”, me qëllim që çdo palë e interesuar të mund të konsultohet dhe të shprehë qëndrimin në ERE në lidhje me përmbajtjen e këtij akti, brenda afateve të parashikuara në Ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në lidhje me sa propozuar nga OST sh.a.
- Lidhur me “Rregullat të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, nuk janë paraqitur komente ose opinione.
- “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, të datës 23 Nëntor 2017, përbëhen nga:

I. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për të gjitha shkëmbimet e energjisë të pa qëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Ky dokument është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale, në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

II. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me Nenin 50 (3), i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Ky dokument gjithashtu është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) në përputhje me Nenin 50 (3), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike. Ky mekanizëm do të përdoret si një mekanizëm i përbashkët i shlyerjes së devijimeve për Evropën Kontinentale për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje).

- Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 55, pika 3, përcakton se: *“Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operationale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe parashikimeve të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal”*.
- Duke marrë në konsideratë detyrimet që OST sh.a., ka si palë e ENTSO-E, si dhe faktin që ky mekanizëm i propozuar është një mekanizëm që është dakordësuar nga gjithë OST-të në Evropën kontinentale, anëtarë të ENTSO – E, për rrjedhojë nuk mund të ndryshojë pasi është mekanizëm i përbashkët që afekton gjithë OST-të anëtare të ENTSO - E.
- Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195, priten të aplikohen nga OST e Evropës kontinentale anëtarë të ENTSO – E, që nga data 1 Qershor 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195, të përberë nga:
 - I. Të gjitha propozimet e TSO-ve kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për të gjitha shkëmbimet e energjisë të pa qëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike (bashkëlidhur këtij vendimi)
 - II. Të gjitha propozimet e TSO-ve kontinentale evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje / ulje) në përputhje me Nenin 50 (3), i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Kostot e krijuara si rezultat i devijimeve nga vlerat nominale do t'i faturohen palëve përgjegjëse për balancimin në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020.
3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë OST sh.a., dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI